


LIRIM DEDA



Zëri
i tokës

poezi

BIBLIOTEKA

E

ZH-1

232

SHTETIT

GJIROKASTËR

214-1
D 32

LIRIM
DEDA

SHKURT
LIBRI

Zëri
i tokës

POEZI



SHTËPIA BOTUESE
«NAIM FRASHËRI»

48922

DASHURI E MADHE

E dua barin, e keni parë barin
kur fërfërin se si këndon e flet?
Në një kërcell të blertë mban vlagën e ugarit
dhe para se të vdesë mbi plis kokën pështet.

E dua erën, erën që flladit e shket
në trupin e pranverës sonë të bardhë.
Dhe mirë e ndiej: kur me shqetësim buçet,
dikush kërkon të shkelë grurin tonë në arë.

E dua Diellin tonë të madh, të bukur,
se jeta jonë atje ka nismë, po fund nuk ka.
Kur rrezia e tij më bie mbi sup lehtë si flutur
kujtoj krahun e Nënës që kurrë në jetë s'm'u nda.

MIDIS DY BETEJAVE

Grykët e skuqura të pushkëve nxjerrin ende tym.
Armiku s'pati kohë të numëronte të vrrarët,
disfata u hodhi përsipër harrim...

Ej, xha Godo,
ç'bën skuadra e parë, ç'prisni?
Labi largoi nga balli një mjegull pikëllimi.

Si një zjarr i madh u ndez kënga e trimave:
«Komisar, o shok i vetëtimave...»

O, ç'qenka kënga
për plagët e rënda.

Në agim do sulmojmë përsëri,
tani duhet fjetur sado pak.

Po s'na ka ikur vetëm gjumi,
na ke ikur ti,
shoku komisar...

Buza na digjet,
qepalla s'na mbyllet.

Ja, erdhën fshatarët me bukë e me ujë,
erdhën dhe tre partizanë të rinj.
Të kërkuan, komisar, por nuk të panë kurrkund.

Në buzë u shquheshin ca fjalë dashurie për ty,
si kokrra gruri në arën e porsakorrur.

E si mund të flihet,
kur ende duket tymi i shtëpive që digjen,
kur presim të na vish,
të ngrihesh me gjithë peshën e plagëve,
trim, o komisar?

NË AGIM DIKUSH TROKET

Sa vite ikën, sa?
Im bir na u bë erë.
Një pushkë hodhi në krah,
në sup shaminë e verdhë...

Dhe iku biri i nënës
tej malesh nëpër natë,
po lehtë si rrezia e hënës
më vjen e ç'mallem prapë:

«Jam unë, o nënë, djali,
të thashë që do vij?...»
— M'u poq në buzë malli,
afroju, xhan, o bir...

Po rrezia e hënës iku
e gjumë s'vë në sy,
ndaj prapë buza i piku:
Ç'u bë, ku shkoi ai?

Në agim dikush troket
lehtë e lehtë në xham.
Është djali që i flet:
«Si fjete, nëno, xhan?»

— Je ti, o syri i vetëm ?
Ç'më ike ashtu mbrëmë,
s'ta dhashë dot e shkreta
një ftua... ta kam lënë...

Tridhjetë vjet e ca
kaluan që atëherë,
po zemra e nënës ja
duron e pret në derë...

Ushtarët ecin në rresht:
ajo shikon të birin,
diku aty në mes,
patjetër më i miri...

Kështu e sheh çdo ditë
të bukur dhe të ri,
ia puth me mall dy sytë,
por dot s'e puth ai...

KA PAS QENË...

Ka pas qenë një i quajtur Bilal,
eh, ç'ka pas qenë.
Kur zbriste nga mali hipur në kalë
bubullonte me gjëmë.

Ka pas qenë një i quajtur Bilal,
eh, ç'ka pas qenë.
Nën potkonjtë e tij gjëmimtarë
njerëzit kallinj gruri në lëmë.

Urdhëronte ai
dhe flakë mirrte pylli në fshatin përballë.
Në pikëllimin përvëlues të tij
feksnin madhështore sarajet...

Me plumbat e pushkëve hakmarrëse të fisit
jetën tonë e ka ngrënë.

Ama, edhe ne, sa na erdhi për Partinë sihariqi,
të egër betimin e bëmë...

Ia morëm të gjitha, çerdhen e gjarpërinjve ia
dogjëm,
ç'ia bëmë aq mirë.

Me gurët e sarajeve ndërnuam themelet për
shkollën,
për gjuhën shqipe të lirë.

QANTE NJË CULE ÇOBANI

Qiellí pus dhe syri pus,
thundër e turkut thikë në shpirt.
Petro Nini një grusht prush
po shpërndan me shkronjat shqip.

Vijnë djem e vijnë pleq,
këmbërrjepur, kurrizdalë.
Dritëron ky alfabet
në çdo fshat, në çdo mëhallë.

Dritëron e mbyllen plagë,
plagët shpella që hap kleri.
Mes për mes u çafsh, moj natë,
në mos na përpiu vreri...

Vreri jo, por mallkimi
i dhespotit është i rëndë.
Petro, të pret shkishërimi,
për ty s'ka jo varr nën hënë...